



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/241
Datë: 27.12.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar, dhe Vendimin e Qeverisë Nr. 43/178 të datës 13.12.2023, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 dhjetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet pagesa e njëhershme në vlerë prej 100 € (njëqind euro) për secilin fëmijë që është përfitues i skemës së shtesave për fëmijë për muajin dhjetor 2024, në kuadër të zbatimit të masës 3.5 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Aprovohet pagesa e njëhershme në vlerë prej 100 € (njëqind euro) për përfituesit e skemave pensionale për muajin dhjetor 2024, në kuadër të zbatimit të masës 3.2 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
3. Nëse përfituesit nga pikat 1. dhe 2. të këtij vendimi janë përfitues nga më shumë se një skemë, atëherë ata mund të përfitojnë vetëm një herë nga shtesa prej 100 € (njëqind euro).
4. Përfundimisht, për shtesën e përcaktuar në pikën 2. të këtij vendimi kualifikohen vetëm ata përfitues, shuma e konsoliduar e të ardhurave nga skemat pensionale e të cilëve nuk tejkalon nivelin 700 € (shtatëqind euro) në muaj.
5. Autorizohet Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve që me vendim të saktësojë kriteret për përfituesit e kësaj mase, nëse është e nevojshme.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/241
Datë: 27.12.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 dhjetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen Ekstrakti i Procesverbalit dhe Transkripti nga mbledhja e 233 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet: 236 dhe 237 elektronike /korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/241
Datë: 27.12.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 dhjetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Aprovohet Rregullorja për Organizimin dhe Funksonimin e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore dhe Funksonimin e Grupit Koordinues Ndërministror.
- Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/241
Datë: 27.12.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit Nr. 03/ L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 dhjetor 2024, merr këtë:


V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25.02. 2022 "Për zbatimin nga Republika e Kosovës të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për vendosje të sanksioneve ndaj Federatës Ruse dhe Bjellorusisë, në raport me situatën në Ukrainë"

1. Pika 1. e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25.02.2022, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: Qeveria e Republikës së Kosovës, zbaton sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes:
 - 1.1. Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 269/2014, (17.03.2014), lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, amendamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) 2024/1745 (24.06.2024) dhe (EU) 2024/1842 (28.06.2024), respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/145/CFSP, (17.03.2014), amendamentuar me vendimet: (CFSP) 2024/1738 (24.06.2024), dhe (CFSP) 2024/1843 (28.06.2024).
2. Të gjitha llojet e sanksioneve, emrat e individëve, entiteteve dhe produkteve, të cilat janë të sanksionuara përmes akteve ligjore të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe anekseve përkatëse të cekura në pikën 1. konsiderohen pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Masat shtrënguese do të jenë në fuqi, deri në një vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen, plotësohen apo ndryshohen.
4. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/241
Datë: 27.12.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 dhjetor 2024, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

- Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit për nevoja të Terminalit Doganor si më poshtë:
 - Terminali Doganor Merdare, ZK Merdare, Komuna Podujevë, sipas tabelave bashkëngjitur këtij vendimi.
- Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
- Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
- Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Subjekti Kërkues/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.
- Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/241
Datë: 27.12.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në zbatim të Ligjit Nr.08/L-165 për Ratifikimin e Vendimit 1/2022 të Këshillit të Stabilizim-Asociimit BE-Kosovë për amendamentimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike dhe Kosovës për të zëvendësuar Protokollin III në lidhje me konceptin e "Produkteve Origjinuese", nenit 2, 6, dhe 42 të Kodit Nr. 08/L- 247 Doganor dhe të Akcizave, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 dhjetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ndryshimet e rregullave të origjinës sipas vendimet të Konventës së Rregullave të Origjinës Pan-Euro-Mesdhetare (PEM):
 - 1.1. Vendimit 01/2023 i datës 7 dhjetor 2023 të Komitetit të Përbashkët të Konventës Rajonale Pan-Euro Mediterane për Rregullat Preferenciale të Origjinës;
 - 1.2. Vendimit 1/2024 i datës 12 dhjetor 2024 i Komitetit të Përbashkët të Pan-Euro-Mediteran për përdorimin e certifikatave të lëvizjes të lëshuara në mënyrë elektronike;
 - 1.3. Vendimit 2/2024 i datës 12 dhjetor 2024 për Aranzhmanet Tranzitore lidhur me aplikimin e Konventës Rajonale Pan-Euro Mediterane për Rregullat Preferenciale të Origjinës nga 1 janar, 2025.
2. Vendimi zbatohet për të gjitha marrëveshjet preferenciale të tregtisë në fuqi në Republikën e Kosovës të cilat zbatohen përmes rregullave të origjinës së Konventës Pan-Euro-Med.
3. Obligohet Dogana e Republikës së Kosovës, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe institucionet tjera përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.
4. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë të njoftoj depozituesin e vendimeve të Komitetit të Përbashkët të Konventës për hyrjen në fuqi të këtij vendimi në Republikën e Kosovës.

5. Vendimi publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ndërsa hyn në fuqi nga data 1 janar 2025.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/241
Datë: 27.12.2024

Në mbështetje të nenit 17, nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafit 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 dhjetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit, Ministres së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për nënshkrimin e Marrëveshjes ndërshtetërore me Islandën, Principatën e Lihtenshtajnit, Mbretërinë e Norvegjisë dhe Konfederatën Zvicerane të cilat përfaqësojnë "Organizatën ndërqeveritare Evropiane për Tregti të Lirë-EFTA.
- Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/241
Datë: 27.12.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 dhjetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Aprovohet Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbeturave në Republikën e Kosovës 2024-2035 dhe Plani i Veprimit 2024-2026.
- Obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit, nga pika 1. e këtij vendimi.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë